Numri: 07 ~ 06/2017.

forumZFD

Balkan PERSPECTIVES

Revistë për ballafaqimin me të kaluarën

BESIMTARËT PËR PAQE

16

SI I KONTRIBUOJNË APO JO ELEMENTET FETARE BALLAFAQIMIT ME TË KALUARËN?

08

Besim apo fe?

03. EDITORIAL

04. VOX POP

06. KUR FEJA BALLAFAQOHET ME TË KALUARËN

08. SI I KONTRIBUOJNË APO JO ELEMENTET FETARE BALLAFAQIMIT ME TË KALUARËN?

10. E KALUARA E NËNË TEREZËS E RREZIKUAR NË MAQEDONI

12. BASHKËSIA ISLAME PO PËRBALLET ME PASOJAT E LUFTËS NË BOSNJE E HERCEGOVINË DHE ME EKSTREMIZMIN NË RRITJE

16. BESIMTARËT PËR PAQE

18. FEJA DHE POLITIKA – NJË KOKTEJ I RREZIKSHËM

20. SFIDAT ME BALLAFAQIMIN ME TË KALUARËN; BESIMTARËT DHE BASHKËSITË FETARE

23. LAJME DHE PËRDITËSIME

24. IMPRESSUM

EDIT-ORIAL

Prishtinë, 7 qershor 2017

Të dashur Lexues,

Edhe pse luftërat në Ballkanin Perëndimor nuk duhet t'i përshkruajmë vetëm si konflikte fetare, roli i fesë nuk duhet të lihet anash kur flasim për ballafaqimin me të kaluarën në Ballkanin Perëndimor. Shumë nisma për ndërtimin e paqes janë të lidhura me lëvizjet fetare, ndërsa terma si pajtimi dhe falja na përkujtojnë vlerat fetare që promovohen nga shumica e institucioneve fetare.

Në numrin e shtatë të revistës Balkan.Perspectives ne kërkojmë të hedhin dritë mbi marrëdhënien mes fesë dhe ballafaqimit me të kaluarën dhe të shqyrtojmë se cilët elemente të besimit mund të mbështesin procesin gjithëpërfshirës të pranimit të ngjarjeve të dhunshme në të kaluarën. Në të njëjtën kohë, duam të flasim edhe për rastet kur feja mund të keqpërdoret për të mbajtur apo nxitur konfliktet dhe si mund të përballemi me instrumentalizime të tilla.

Në kryeartikullin e revistës, Zllatiborka Popov Momçinoviq na jep një vështrim të përgjithshëm të rasteve kur feja botërore ka luajtur rol të rëndësishëm në ballafaqimin me të kaluarën dhe se si besimet fetare mund t'iu ndihmojnë njerëzve të kenë besim në proceset e pajtimit.

Muhamed Jusiq ka një qasje më kritike ndaj gjendjes së dialogut ndërfetar në Bosnie e Hercegovinë. Sipas tij, përpjekjet që janë bërë deri më sot për t'i kontribuar pajtimit nuk janë përshtatur me realitetin e përditshmërisë së njerëzve në Bosnie e Hercegovinë. Prandaj, ai kërkon zotim më të fuqishëm për procesin e pajtimit dhe jep disa rekomandime konkrete për të ardhmen.

Edhe Dardan Hoti ka një qasje të ngjashme kur shtjellon potencialin e disa bashkësive fetare në Kosovë kur bëhet fjalë për ballafaqimin me të kaluarën. Ai ka biseduar me disa nga udhëheqësit fetarë dhe sjell perceptimet e tyre për gjendjen në Kosovë.

Shpëtim Nuredini e merr shenjtërimin e Nënë Terezës si shembull për të treguar se si feja në Maqedoni po politizohet dhe pse përkatësia fetare ende është e ndërlidhur ngushtë me përkatësinë etnike të njerëzve. Todor Pendarovi komenton për marrëdhënien ndërmjet fesë dhe politikës në Maqedoni dhe e kritikon këtë përzierje, pasi po pengon procesin konstruktiv të ballafaqimit me të kaluarën.

Safeta Bishevac ka shtjelluar gjendjen e bashkësive islame në Sanxhak dhe perceptimin për ekstremizëm në rritje brenda bashkësive që deri më tani janë njohur për pranimin paqësor të të tjerëve. Ajo paraqet dhe krahason gjendjen atje gjatë luftës në vitet '90 dhe sot.

Si gjithnjë, ne i mirëpresim komentet dhe vërejtjet tuaja për këtë numër dhe shpresojmë që leximi i revistës të jetë i dobishëm dhe frymëzues. Nëse dëshironi të abonoheni apo të dërgoni ndonjë koment tjetër, ju lutemi na shkruani në adresën balkan.perspectives@forumzfd.de

Po ashtu, shfrytëzoj rastin t'ju them lamtumirë. Ky është numri i fundit ku unë jam kryeredaktore. Më ka pëlqyer çdo moment i punës me ekipin redaktues dhe shpresoj që lexuesit do të vazhdojnë ta lexojnë me ëndje revistën Balkan.Perspectives.

Me të mira,
Maike Dafeld
Kryeredaktore

ÇFARË
ËSHTË
FEJA
PËR JU?

BOSNIA DHE HERZEGOVINA

Feja është shumë e rëndësishme për mua, sepse na ndihmon të përballemi me vështirësitë e jetës dhe na ndihmon të marrim vendime të mira.
Amila, 30

Për mua, feja është diçka që më përket vetëm mua dhe nuk ka nevojë të shfaqet në publik.
Rusmira, 29

Feja është një makineri e tejkaluar, korporatiste dhe politike, që shfrytëzon brishtësinë e mendësisë së njeriut . Ajo është një mënyrë për të kontrolluar masat dhe për të burgosur lirinë e njeriut, duke i dhënë shpresa të rreme për diçka imagjinare.
Zlatko Ç., 27

KOSOVA

Për mua, feja nënkupton Paqe. Mendoj se po të mos kishte fe, shumë gjëra në botë do të ishin ndryshe.
Fisnik S. 32

Shërbim, adhurim, diçka që ka të bëjë me kultin e zotave.
Atdhedona Rr. 27

Për mua, feja është: të besoj se ka një Zot, se Zoti është gjithkund (në kishë, në xhami, në rrugë, në teqe, kudo); të mos bëj keq dhe gjithnjë të përpiqem të bëj mirë.
Rrezearta B. 33

Feja është besimi që shtjellon shkakun, natyrën dhe qëllimin e universit, që kërkon devotshmëri dhe rituale.
Selvie I. 35

SERBIA

Si një person jofetar, fenë e shoh si forcë politike dhe shoqërore, jo si diçka personale. Në rajonin tonë, kisha është instrument i ideologjive politike dhe anasjelltas. Ato mbështesin njëra-tjetrën për të drejtuar kufijtë apo për të krijuar të rinj, duke ngritur mure të padukshme ndërmjet njerëzve dhe duke ushqyer urrejtje ndaj së ndryshmes. Kjo është e kundërta e thelbit të fesë.
Gjurdja Gj, 30

Për mua feja nuk do të thotë gjë. Njerëzit i shoh si të mirë apo të këqinj pavarësisht fesë së tyre. Gjatë të gjithë historisë, feja është (keq)përdorur për një sërë mizorish që kanë ndodhur në rajonin tonë. Njerëzit kanë bërë mizori në emër të Zotit, ndaj unë përpiqem të mendoj me kokën time.
Marija V, 32

Feja është të kesh besim në diçka përtej vetes; diçka madhështore, që ndodhet gjithkund, diçka që sjell shkakun dhe pasojën njëjtë për të gjithë, pa sterotipe apo paragjykime dhe pa ngarkesa të arsyeshmërisë. Feja është të kesh besim tek diçka e bukur, si dashuria, por shumë më tepër se aq.
Miloranka T, 30

MAQEDONIA

Feja është besimi në Zot. Është besimi në diçka të shenjtë që udhëheq jetën tonë shpirtërore.
Violeta.K 43

Feja është të besosh në Zot, i cili na thotë të duam dhe të respektojmë veten në radhë të parë dhe pastaj të tjerët.
Irina.S, 37

Feja është mjet për të kontrolluar masën e qytetarëve dhe për të përçarë njerëzit.
Milcho.S 30

KUR FEJA BALLAFAQOHET ME TË KALUARËN

Duan apo jo, ditët para festës së Bajramit, shumë myslimanë marrin draprin, një shat të vogël, ca lule e lecka, e nisen drejt varrezave. Ky është një ritual të cilin ata nuk e humbin kurrë. Ata nisen për në varreza që t'ua bëjnë "hyzmetin" më të dashurve të tyre, tash të vdekur. Kjo ndodh edhe për sy të të tjerëve. Kur në mëngjesin e ditës së Bajramit përfundon falja e kësaj feste të myslimanëve, familjarë të shumtë shkojnë në varreza dhe i gjejnë, në shumicën e rasteve të pastruara dhe kujtojnë ata që kanë shkuar. Ky është vetëm një rast kur myslimanët në Kosovë ballafaqohen me të kaluarën, praktikisht me anë të një feste fetare.

Por në përgjithësi, e kaluara dhe feja shpesh janë të diskutueshme në urën ndërmjet paqes dhe luftës. Të gjitha fetë flasin për paqen dhe lufta përmendet aq sa mund numërohet me gishta. Tony Selimi, një ekspert i njohur ndërkombëtarisht për sjelljen e të menduarit dhe inteligjencën emocionale të njeriut, thotë se "Është e debatueshme të thuhet që është ndonjë luftë ku kauza primare dhe luftimi janë bërë për shkak të fesë. Në të njëjtën kohë, gati të gjitha konfliktet ose luftërat e rëndësishme kanë pasur ndonjë aspekt fetar, ose ndonjë lidhje me një çështje fetare. Ka luajtur një rol të fortë në shume konflikte të vogla e të mëdha, në luftëra botërore dhe civile dhe në shumicën e luftërave të sotme". Meqë shpesh feja është element në konflikte dhe luftëra, duhet të merret parasysh kur flasim për pajtim dhe ballafaqimin me të kaluarën.

Kontributi i fesë në shoqëri paqësore dhe përkeqësimi i mundshëm

Në Kosovë, dialogu ndërfetar ka filluar të merret me këtë sfidë dhe të bëjë bashkë përfaqësues nga bashkësi të shumta fetare. Dom Lush Gjergji, një klerik katolik e sheh pjesëmarrjen në dialog të tillë si rolin kryesor të udhëheqësve fetarë: "Dialogu ndërfetar është sot një ndër çështjet më të rëndësishme për shoqërinë në Kosovë".

Pozicioni i tij është shumë i ngjashëm me atë të Imam Sabri Bajgorës. Bajgora thotë se misioni i feve është të lartësojnë njeriun, jo të nxisin urrejtjen që mund të ushqejë luftëra dhe ai ka vlerësim për dialogun ndërfetar në Kosovë: "Mision parësor i feve qiellore është

që të kontribuojnë për paqe, tolerancë, dashuri, respekt e mirëkuptim. Bashkësitë fetare të pasluftës në Kosovë kanë dhënë një kontribut të çmuar për ndërtimin e paqes dhe krijimin e mirëbesimit. Dëshmi e kësaj janë dhjetëra takime e konferenca ndërfetare, me të vetmin qëllim zhdukjen e urrejtjes në mes popujve që jetojnë në Kosovë", shprehet Imam Sabri Bajgora. Nëse feja mund të kontribuojë për një shoqëri paqësore, për të është pyetje që e ka përgjigjen të gatshme: "Jo vetëm që mundet, por mision parësor i feve qiellore është që të kontribuojnë për paqe, tolerancë, dashuri, respekt e mirëkuptim." Në Kosovë, bashkëpunimi ndërfetar është arritur përmes takimeve dhe konferencave të përbashkëta, në përpjekje për të ndarë fenë nga ndikimi i politikës.

Xhabir Hamiti, ligjërues në Fakultetin e Studimeve Islame, thekson fjalët "bashkëpunim ndërfetar" si fjalë kyçe për një shoqëri paqësore afatgjatë në Kosovë. Ai madje konsideron se udhëheqësit fetarë janë personat e duhur për të qetësuar konfliktet politike dhe kombëtare në vend. Për të arritur këtë, Hamiti thotë se duhet t'i shmangemi nënshtrimit.

Dialogu ndërfetar paqësor në rrezik?

"Për të arritur një bashkëpunim pozitiv dhe për të kultivuar një të mirë të përbashkët të qytetarëve, komunitetet fetare duhet të mos lejojnë që të bëhen vegël e asnjë organizate të jashtme fetare, por të jenë vetvetja, sepse të mirën e dheut, vendit dhe ambientit në të cilin ata frymojmë nuk mund ta dojë askush më shumë se sa ata vetë", thotë Hamiti. Përveç rrezikut për politizimin e bashkësive fetare, Hamiti shton se mungesa e stabilitetit politik në vend dëmton, pengon dhe pamundëson bashkëpunimin e mirëfilltë ndërfetar.

Këtë e mbështet edhe Bajgora: për të, Ballkani i përngjan një zjarri të shuar që mund të ndizet shumë lehtë sa i përket konflikteve me të cilët është përballur rajoni që në vitet '90. Edhe pse konfliktet në Ballkan nuk janë motivuar nga feja, ndarja përgjatë përkatësisë fetare në rajon nuk ka mundësuar zgjidhje paqësore të konflikteve.

Dom Lush Gjergji sheh kontributin e fesë ndaj shoqërisë dhe thotë se kjo mund të ndodhë vetëm kur feja është e vërtetë në vete: "Mund të japë një kontribut të madh, kuptohet, nëse është fe e mirëfilltë, d.m.th. shërbim ndaj Zotit dhe të të afërmve, ose mund të japë kontribut negativ kur politizohet, manipulohet, degradohet, pra kinse thirret në emër të Zotit por është kundër Atij dhe Njeriut, pra, pa vlera dhe virtyte shpirtërore."

Elemente të fesë që mund të ndihmojnë me procesin e ballafaqimit me të kaluarën

Edhe pse dialogu i jopolitizuar dhe ndërfetar mund t'i kontribuojë ndërtimit të paqes dhe ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë në nivel shoqërie, elementët dhe ritualet fetare mund t'iu ndihmojnë individëve të kapërcejnë vuajtjet.

Për Dom Lush Gjergjiin nevojiten shumë dy parime bazë: e vërteta dhe dashuria. Që të dyja na bëjnë të mundur të pranojmë të kaluarën, edhe pse në të mund të ketë gabime, që nuk mund të ndryshohen, mirëpo mund të rishikohen. Dom Lush Gjergji thotë se nëse nevojitet "ne duhet t'i përmirësojmë, të kërkojmë për falje dhe të harrojmë me fuqinë e besimit dhe dashurisë".

Përveç kësaj, ritualet fetare si lutja apo falja mund t'u japin individëve mbështetje. Sipas Tony Selimit, lutja apo falja është formë e meditimit që iu ndihmon njerëzve të qetësojnë mendjen dhe t'i fokusojnë shpirtrat dhe për disa njerëz mund të sjellë çlirim dhe rehatim.

Edhe pse jo të gjithë mund të ndërlidhen me spiritualitetin dhe fenë, është interesante të shohësh mundësinë që ofrojnë të dyja kur është fjala për ballafaqimin me të kaluarën. Institucionalizimi i dialogut ndërfetar mund të shihet sot si një tjetër hap i Kosovës drejt pajtimit dhe paqes. Do të jetë interesante ta përcjellim këtë proces në vitet e ardhshme për të parë nëse mund të jepen kontribute të suksesshme nga udhëheqës të ndryshëm fetarë.

***Dardan Hoti** është gazetar dhe redaktor që ka punuar në median e Kosovës për më shumë se gjashtë vite. Ai ka fituar çmimin e gazetarisë për varfërinë të dhënë nga Ekipi i Kosovës i Kombeve të Bashkuara në vitin 2013. Dardani ka qenë anëtar i Bordit të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës që nga viti 2014, tani në mandatin e tij të dytë.*

Zllatiborka Popov Momçinoviq, *PhD, Asistent Profesore, është profesore e shkencave politike në Universitetin e Sarajevës Lindore, Bosnje e Hercegovinë. Ajo ka BA për sociologji nga Fakulteti i Filozofisë në Novi Sad. Përveç punës së saj kërkimore akademike, Dr. Momçinoviq ka qenë pjesëtare aktive e shoqërisë civile në rajon. Nga viti 2005 ajo është angazhuar si asistente në Fakultetin e Filozofisë në Sarajevën Lindore, ku mbrojti masterin me temë "Kultura politike në periudhë tranzicioni". Në Fakultetin e Shkencave Politike, Universiteti i Beogradit, ajo mbrojti temën e doktoraturës rreth lëvizjes së grave në Bosnje e Hercegovinë që më vonë u botua si libër "Lëvizja e grave në Bosnje e Hercegovinë: artikulimi i një kundër-kulture". Ajo ka publikuar me shumë se 60 artikuj që merren me çështjet gjinore, aktivizmin, pajtimin, shoqërinë civile dhe rolin publik të fesë. Prej katër vjetësh Dr. Momçinoviq është anëtare e ekipit hulumtues në kuadër të projektit Faktorët e pajtimit në Bosnje e Hercegovinë, në bashkëpunim me Universitetin e Edinburgut. Ajo gjithashtu është angazhuar si eksperte dhe ligjëruese në kuadër të projektit PRO Future, të lansuar nga Catholic Relief Service me mbështetje nga USAID-i, që merret me çështjen e paqes dhe pajtimit nëpër komuna në Bosnje e Hercegovinë.*

Si i kontribuojnë apo jo elementet fetare ballafaqimit me të kaluarën?

Shpesh, feja shihet si pengesë për ballafaqimin me të kaluarën, sidomos në rajonin tonë. Bashkësitë fetare dhe kishat krijojnë narrativat e veta, ndërsa monumentet fetare memorializojnë kujtesë ekskluzive dhe selektive. Këto monumente përcjellin një ndjesi të viktimizimit, duke u bërë homazhe vetëm narrativës së vet, ndërkohë që të tjerët i portretizojnë në mënyrë më abstrakte dhe më dehumanizuese. Shpeshherë, diskursi fetar u qaset viktimave në mënyrë të tillë që ato "bien në nivel të njëjtë". Madje dhe vetë shkrimtari i madh gjerman, fitues i Çmimit Nobel, Hajnrih Bël (Heinrich Böll), ka paralajmëruar në esenë e tij Der Preis der Versöhnung (Çmimi i pajtimit) për rrezikun që vjen nga një qasje e tillë e ''mbajtjes së barazpeshës sikurse bilanci në kontabilitet".



Ballafaqimi me të kaluarën duhet të kuptohet në kontekst të pajtimit dhe si një ''strategji me shumë fytyra". Pa atë kontekst, ballafaqimi me të kaluarën shndërrohet në qëllim në vetvete dhe nuk është i orientuar mjaftueshëm nga e tashmja dhe e kaluara.

Qëllimi të cilit duket se i shërbejnë fetë, nëse vështrojmë këtë shprehje ciklike të pajtimit, është të shprehin vuajtjen, humbjet dhe përvojat traumatike të grupeve të veta. Kjo gjë konfirmon sërish ideologjinë e nacionalizmit dhe komunikimit fetar që kanë legjitimizuar konfliktet në rajon. Duhet përballje me një praktikë të tillë brenda vetë radhëve të fesë, sepse ata janë ende në veprim.

Mirëpo radhët fetare në rajonin tonë pothuajse nuk janë angazhuara. Ato kanë një qasje selektive sa i përket disa segmenteve të kësaj teme, si e vërteta dhe falja. Për shembull, e vërteta është e natyrës shkencore, narrative, e ndërlidhur me dialogun dhe shëruese. Narrativat tona fetare japin hapësirë vetëm për narrativat e veta dhe jo për ato të të "tjerëve". Ato krijojnë hapësirë për qasjen e tyre shkencore që funksionon si martirologji, pra hapësira për kultin e tyre të therorit. Falja gjithnjë pritet nga ana tjetër, gjë që bart rrezikun që krimet të përsëriten në mënyrë ciklike. Miroslav Volfi, një teolog nga Ballkani, ka parashtruar në esenë e tij "Të kujtojmë gabimet si duhet, se na duhet" të sillemi a thua se gjithçka në të kaluarën është falur, edhe nëse nuk është ashtu. Vetëm një pozicion i tillë nuk rezulton në dëshirën për hakmarrje, që pastaj bën të përsëritet e kaluara. Gjithashtu, fetë konfirmojnë transhendencën e tyre, përpjekjen për një botë të përtejshme më të mirë dhe më të lartësuar që ofron horizonte më të gjera dhe më të bukura. Në kontekstin e krishterë, feja ofron hapësirë për lindjen jo vetëm të njeriut të ri, por edhe të rolit të vet origjinal dhe autentik.

Kemi se çfarë të mësojmë nga disa prej shembujve pozitivë që i gjejmë në vende të tjera. Për shembull, roli i teologëve gjermanë pas L2B apo roli i peshkopëve anglikanë në Afrikën e Jugut gjatë dhe pas apartejdit. Peshkopi anglikan i Afrikës së Jugut Desmond Tutu ka luajtur një rol posaçërisht të rëndësishëm për themelimin e Komitetit të Drejtësisë Tranzicionale. Ndërkohë, klerikë nga Ballkani jo vetëm e kanë vënë në pikëpyetje institucionin, por edhe punën e një komiteti të tillë në Bosnje e Hercegovinë.

Pas krimeve të nazistëve, teologët gjermanë kanë bërë pyetjen e rëndësishme se a ishte më i mundshëm krishtërimi pas Aushvicit[1], duke sfiduar se në kampet e vdekjes nuk kishte vdekur judaizmi, por krishtërimi, pasi tmerret e ndodhura kishin nxjerrë në dritë anti-semitizmin e fshehur. Në rastin tonë, këto pyetje nuk janë bërë[2], përveçse nga pak teologë apo klerikë të margjinalizuar. Megjithatë, ato sigurisht janë një zë i rëndësishëm që ka nevojë të dëgjohet më shumë dhe të ketë më shumë forma të mbështetjes. Teologët gjermanë gjithashtu kanë thënë se feja duhet të jetë hapësirë për "kujtime të rrezikshme" dhe se ajo mund të marrë rol krijues, në vend se të ruajë privilegjet e veta apo të ndjejë keqardhje për kohëra më të lumtura kur ekzistonte aleanca mes "fronit dhe altarit". Fetë janë më të lidhura me shtetin dhe më pak me shoqërinë, madje dhe me besimtarët. Kështu, organizatat fetare përplasen me elitat e komuniteteve, duke luajtur një rol të rëndësishëm në prodhimin e kujtesës selektive që në fund shndërrohet në një "histori të fshehtë gjysëm-zyrtare".

Megjithatë, ka vend për optimizëm, si për shembull nismat e disa prej teologëve që përmendëm më lart; nëpër takime për dialog edhe pse ato shpeshherë mbeten në nivel normativ dhe në nisma të përbashkëta lokale që përqendrohen tek e ardhmja dhe nuk e mohojnë të shkuarën, por e tejkalojnë atë në mënyrë kreative dhe me përgjegjësi shoqërore. Angazhimi i teologeve dhe besimtareve (femra) është me rëndësi të posaçme, mirëpo ato nuk janë mjaftueshëm në syrin e publikut për shkak të kulturës misogjene dhe strukturave fetare patriarkale. Format institucionale për ballafaqimin me të kaluarën dhe dialogun kanë mangësitë e veta. Është me shumë rëndësi që në Bosnje e Hercegovinë të funksionojë Këshilli Ndërfetar dhe ai të ketë degët e veta lokale zyrtare. Këshilli Ndërfetar nxjerr botime të rëndësishme që vënë në dukje diversitetin e shoqërisë së Bosnje e Hercegovinës, reagon në rastet e sulmeve ndaj objekteve fetare dhe mbështet takimet e teologëve të rinj. Në nivel lokal ka shumë projekte të përbashkëta që merren me përditshmërinë e njerëzve dhe që sigurojnë tejkalimin e interpretimeve dehumanizuese dhe të shfytyruara të së kaluarës.

Studime si projekti katër-vjeçar në Edinburg për proceset e pajtimit në Bosnje e Hercegovinë[3] tregojnë se besimtarët në rajon, pavarësisht bashkësisë së tyre fetare, kanë më shumë besim tek procesi i pajtimit se sa personat jofetarë. Pra, personat fetarë kanë mbështetur nisma të ndryshme në nivel vertikal (zyrtare) dhe horizontal (shoqërore dhe njerëzore). Kjo është një gjetje e rëndësishme, që nxjerr përfundimin se besimtarët munden dhe duhet të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme dhe më kreative që e trajtojnë të kaluarën në mënyrë të ndryshme për të krijuar një të tashme dhe të ardhme më të mirë në rajon. Pajtimi është proces, një lëvizje e vazhdueshme përmes së kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes. Prandaj, këto sekuenca kohore nuk mund dhe nuk duhet të ndahen për të krijuar narrativa gjithëpërfshirëse. Besimi dhe fetaria gjithashtu krijojnë hapësirë për ''rebelimin e zemrës" kundër formave të së ligës, të vjetra e të reja, që krijojnë "kakofoninë në prapavijë" - frazë kjo nga Mirosllav Volf, të përditshmërisë tonë, përfshirë dhe atë fetare.

1 - Që është një perifrazim i tezës së Adornit se poezia nuk është më e mundur pas Aushvicit.

2 - Sikurse pyesin disa teologë (si Nikolla Knezheviq, Allen Kristiq, Zoran Grozdanov etj.) se ku ishte ortodoksia në Srebrenicë, katolicizmi në Jasenovac, etj.

3 - Theks i posaçëm i këtij hulumtimi është feja si faktor gjatë procesit të rehabilitimit: www.ceir.co.rs/diskursi/uploads/2013/dec/Edinburg%20Bos.pdf

Shpëtim Nuredini
Redaktor udhëheqës në RTM2 (MPT2), ish-korrespodent i televizonit satelitor ALSAT, Tiranë.

E kaluara e Nënë Terezës e rrezikuar në Maqedoni

Shoqëritë ballkanase, posaçërisht në Maqedoni, për shumë kohë do ta ketë të vështirë ballafaqimin me të kaluarën. Arsyeja për këtë sfidë është mungesa e vullnetit për të njohur veten edhe ashtu siç të njohin të tjerët dhe për të pranuar të tjerët ashtu siç e pranojmë veten. Mungesa e vullnetit për të kërkuar faktet historike dhe tendenca për të keqpërdorur historinë dhe identitetet dolën në sipërafqe me rastin e shenjtërimit të Nënës Terezë.

A ishte Nënë Tereza shqiptare, maqedonase, apo vllahe?! A ishte shkupjane e Shkupit të Shqipërisë apo shkupjane e Shkupit të Maqedonisë?! A ishte besimtare e vyeshme katolike me të cilën duhet të krenohen edhe besimtarët myslimanë e ortodoksë, apo duhej të anatemohet pasi nuk i përkiste besimit që të tjerë deshën?!

Dilemën për këtë çështje shenjtorja e kishte sqaruar vetë, në një thënie të vetme, që paraqet kartën e saj të identitetit: "Me gjak, unë jam shqiptare. Me shtetësi, jam indiane. Me besim, unë jam një murgeshë katolike. Me thirrje, unë i përkas botës. Për nga zemra ime, unë i përkas plotësisht zemrës së Jezusit", ka thënë Nëna Terezë, e lindur Gonxhe Bojaxhiu. Mirëpo në vend që të pranohej si një personalitet unik dhe i jashtëzakonshëm, identiteti i saj është politizuar tej mase.

Edhe pse njeriu paraqet një mozaik identitesh, në Maqedoni shumë i kufizojnë identitetet dhe përkatësinë etnike të një personi. Fakti që Nënë Tereza ishte me prejardhje shqiptare dhe në të njëjtën kohë e besimit katolik iu vu kundër këtyre perceptimeve të thjeshtuara. Nënë Tereza ishte edhe shqiptare, edhe katolike, tani më edhe shenjtore.

Komuniteti shqiptar në Maqedoni ndjehet shpesh i shpërfillur dhe i papërfaqësuar. Prandaj, fakti që origjina e Nënës Terezë u shpërfill gjatë ceremonisë së shenjtërimit nuk u prit mirë. Presidenti i shtetit, Gjorge Ivanov, mundi të numërojë të gjitha identitetet e shenjtores Nënë Terezë, por jo edhe identitetin e saj etnik. Madje, për të qenë edhe më konfuz, ai nuk e përmendi as emrin e saj të pagëzimit Gonxhe. Edhe Ministri i Kulturës, edhe Ipeshkvi i Kishës Katolike bënë të njëjtin gabim. Gjatë ceremonisë përkujtimore të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë kushtuar shenjtërimit të Nënë Terezës, Kryetari i saj Taki Fiti tha se Nënë Tereza rrjedh nga një familje me prejardhje të përzier etnike, duke nxitur kështu shumë reagime negative.

Ngjarjet lidhur me shenjtërimin e Nënë Terezës treguan edhe njëherë se shoqëria maqedonase jo që vetëm nuk ka kapacitete për t'u ballafaquar me të kaluarën, por i hedh benzinë zjarrit të përçarjes etnike dhe konflikteve përbrenda shoqërisë.

Një ndër lutjet monumentale të Nënë Terezës është lutja që ajo bëri gjatë fjalimit në OKB në vitin 1985, ku ndër të tjera ajo tha: "O Zot, më jep fuqi t'u jap paqen, të sjell të vërtetën atje ku ka gabime." Maqedonia ka ende punë për të bërë për të sjellë versionin e së vërtetës që mund të pranohet nga disa anë. Duke u marrë me këtë gjë, ne kemi nevojë të takohemi me njëri-tjetrin në paqe, tolerancë, respekt të ndërsjellë dhe të përmirësojmë gabimet. Duhet t'i lëmë pas vetes modelet e të menduarit të zakonshëm nacionalist dhe të ndërveprojmë me njëri-tjetrin si pjesëtarë të barabartë të kësaj shoqërie.

Nënë Tereza mund të jetë një shembull i mirë gjatë një procesi të tillë.

Bashkësia islame po përballet me pasojat e luftës në Bosnje e Hercegovinë dhe me ekstremizmin në rritje

Në fillim të vitit 2014, Mirza Ganiq, një nëntëmbëdhjetë vjeçar nga Novi Pazari, vdiq në afërsi të Alepos gjatë një beteje ndërmjet Ushtrisë së Lirë Siriane dhe ISIL-it. Ai njihej si një fëmijë i bindur, si nxënësi më i mirë i klasës në shkollë fillore dhe nëntëvjeçare. Dy muaj para përfundimit të shkollës, ai papritmas u largua për në Siri që të luftonte për ISIL-in, pa dijeninë e familjes së tij. Ai i kontaktoi ata vetëm pasi kishte arritur në Siri.

Mirza e përdorte Facebook-un për të ndarë fotot dhe të rejat nga lufta. Ai gjithashtu u dërgonte kërcënime politikanëve boshnjakë dhe aktivistëve të OJQ-ve, duke i akuzuar se kishin tradhëtuar islamin. Mirza nuk ishte i pari person nga Sanxhaku që luftoi dhe u vra në Siri, mirëpo ai tërhoqi shumë vëmendje, pasi ishte një i ri i dalluar. Edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare, media spekulon për numrin e njerëzve që kanë ikur nga Serbia për të luftuar për ISIL-in duke thënë se janë kryesisht boshnjakë nga Sanxhaku. Shifrat shkojnë nga disa dhjetëra në qindra. Më shumë se një duzinë e këtyre luftëtarëve janë vrarë. Numri i burrave nga Sanxhaku që i janë bashkuar ISIL-it ra në mënyrë drastike kur Serbia miratoi ligjin për kriminalizimin e individëve që luftojnë në fushëbeteja të huaja, gjë që dënohet me burgim. Arsyeja e rënies së numrit të individëve që shkojnë të luftojnë në Siri mund të jetë edhe rënia e popullaritetit të ISIL-it. Kur diskutojmë për këto sfida të reja në Serbi, na paraqiten disa çështje. Për shembull, çfarë i ka motivuar boshnjakët e rinj që të shkojnë të luftojnë në Siri? A po rritet vërtet ekstremizmi në Sanxhak dhe nëse po, çfarë roli luajnë institucionet myslimane?

Ndikimi i luftës në Bosnje e Hercegovinë

Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, islami është feja e tretë më e praktikuar në Serbi. Nga 7.2 milionë banorë në Serbi, rreth 220,000 janë myslimanë, që do të thotë rreth 3% e popullsisë. Shumica e myslimanëve janë boshnjakë, prej të cilëve rreth 145,000 jetojnë në Sanxhak. Në gjashtë komunat e Sanxhakut në Serbi ka mbi 238,787 banorë; 76,590 (32%) janë të krishterë ortodoksë dhe 156,575 (65.5%) janë myslimanë. Në ish-Jugosllavi, ka patur një bashkësi islame të vetme. Selia dhe udhëheqësi fetar (reis-ul-ulema) ishin në Sarajevë. Gjatë luftës në Bosnje e Hercegovinë, bashkësia islame nuk ishte në gjendje të funksiononte si duhej, ndaj filloi të vetëorganizohej. Bashkësia myslimane në Sanxhak themeloi Bashkësinë Islame të udhëhequr nga myftiu Muamer Zukorlliq. Qeveria e Millosheviqit refuzoi ta pranonte këtë organizatë fetare, duke pretenduar se ishte organizatë politike me qëllime separatiste. Që nga viti 2007, në Serbi janë dy organizata fetare myslimane që nuk e njohin njëra-tjetrën. Bashkësia islame në Serbi është e lidhur me homologen e saj në Bosnje e Hercegovinë me udhëheqësin fetar reis-ul-ulema-në në Sarajevë, që udhëhiqet nga kryemyftiu Mevlud Dudiq. Bashkësia islame e Serbisë e udhëhequr nga reis-ul-ulema-ja Sead Nasufoviq bashkëpunon me Sarajevën, edhe pse ai avokon për një bashkësi fetare të pavarur për myslimanët në Serbi. Nuk ka ndonjë dallim teologjik ndërmjet të dy bashkësive, mirëpo ato dallojnë sa i përket njohjes së selisë, një në Sarajevë dhe tjetra në Beograd. Kështu, Qeveria e Serbisë ka mbrojtur, për arsye politike, Bashkësinë Islame në Serbi. Edhe Kryeministri Aleksandar Vuçiq ka krijuar marrëdhënie miqësore me ish-kryemyftiun e Bashkësisë Islame në Serbi Muhamed Zukorlliq, i cili u largua nga pozita fetare për politikë. Aktualisht, ai është deputet i Kuvendit të Serbisë dhe mbështetës i qeverisë së Vuçiqit.

Lufta në Bosnje e Hercegovinë nga viti 1992 deri në vitin 1995 vuri në provë marrëdhëniet e mëhershme miqësore ndërmjet të krishterëve ortodoksë dhe myslimanëve në Serbi. Edhe pse Serbia zyrtarisht nuk mori pjesë në luftë, udhëheqja politike dhe ushtarake nën Sllobodan Millosheviqin, Radovan Karaxhiqin dhe Gjeneralin Ratko Mlladiq, si dhe vullnetarët nga Serbia, mbështetën dhe luftuan përkrah ushtrisë serbe të Bosnjes. Ngaqë lufta në Bosnje e Hercegovinë kishte të bënte edhe me fenë, ajo ndikoi në marrëdhëniet ndërfetare dhe ndëretnike në Serbi, si dhe në zonat kufitare të Bosnje e Hercegovinës, ku boshnjakët myslimanë përbënin një pjesë të konsiderueshme të popullsisë. Lufta në Bosnje e Hercegovinë ka ndikuar në mënyrë joproporcionale tek myslimanët në Sanxhak, një zonë që kufizon Serbinë, Malin e Zi dhe Bosnje e Hercegovinën. Sulmet më të mëdha kundër

myslimanëve, kundër pronës së tyre dhe objekteve fetare u bënë në Bukovicë, një fshat pranë Pljevljes në Sanxhak që gjendet në Malin e Zi dhe pranë Pribojit në Serbi. Gjatë viteve të fundit, Mali i Zi dhe Serbia kanë investuar miliona euro në Bukovicë dhe Priboj për të rindërtuar shtëpitë e myslimanëve dhe ndërtesat e tjera të shkatërruara gjatë luftës. Mirëpo askush nuk ka dhënë përgjegjësi për krimet e kryera. Dy rastet më të njohura të rrëmbimit dhe vrasjes së boshnjakëve myslimanë nga ish-Republika Socialiste e Jugosllavisë dhe aktualisht, Serbia dhe Mali i Zi, janë "Sjeverini" dhe "Shtërpci". Më 22 tetor 1992, 17 boshnjakë u rrëmbyen në fshatin Mioça (Komuna Rudo në një pjesë të Bosnje e Hercegovinës ku shumica e popullsisë është serbe) nga një autobus që transportonte pasagjerë nga fshati Priboj, në drejtimin Sjeverin-Priboj. Ata u dërguan në Vishegrad (Bosnje e Hercegovinë), u torturuan dhe u vranë. Në shkurt 1993, 20 pasagjerë, 19 boshnjakë dhe 1 kroat, i cili bëri rezistencë ndaj rrëmbimit të këtyre njerëzve, u rrëmbyen nga një tren që udhëtonte në drejtimin Beograd-Tivar në fshatin Shtrpci, po ashtu pjesë e Bosnje e Hercegovinës që kontrollohej nga forcat serbe. Personat e rrëmbyer u dërguan në një lokacion të paditur dhe u vranë.

Pavarësisht krimeve të kryera kundër boshnjakëve nga Sanxhaku, është interesante të vëmë re se gjatë luftës nuk ka patur asnjë rast të ekstremizmit fetar, ndërfetar apo ndëretnik në Sanxhak. Fakti që serbët dhe boshnjakët në Sanxhak respektojnë njëri-tjetrin u bë i qartë edhe më 17 mars 2004, pas mbytjes së dy fëmijëve shqiptarë në lumin Ibër në Mitrovicë. Për këtë u akuzuan si përgjegjës serbët nga një fshat fqinj, por pa ndonjë dëshmi, sikurse doli më vonë. Me këtë rast, shqiptarët sulmuan serbët në Kosovë dhe shkatërruan shumë kisha dhe manastire. Të njëjtën mbrëmje, serbët u kundërpërgjigjën duke u vënë flakën xhamive në Beograd dhe Nish dhe pati një sërë sulmesh kundër shqiptarëve dhe myslimanëve dhe pronave të tyre. Në Sanxhak, gjithçka ishte qetë dhe bashkësia islame atje dënoi sulmet e motivuara nga feja në Kosovë dhe në Serbinë qendrore; ajo u bëri thirrje besimtarëve që të mos bëheshin pjesë e histerisë dhe të mos kërkonin hakmarrje. Në atë periudhë, Myftiu Zukorlliq ftoi xhematin e tij që t'i kushtonte rëndësi të posaçme dhe të mbronte ndërtesat ortodokse pranë Novi Pazarit, manastiret Gjurgjevi stupovi dhe Sopoqani, si dhe Kishën e Pjetrit.

***Pikëpamjet e udhëheqësve fetarë myslimanë**

Boshnjakët në Sanxhak e pranuan islamin gjatë sundimin pesë-shekullor të osmanëve. Si një popull evropian me origjinë sllave, që kanë jetuar me pjesëtarë të feve të ndryshme për breza të tërë, boshnjakët janë myslimanë suni më liberalë. Shumë njerëz janë befasuar nga paraqitja e pikëpamjeve më radikale të islamit që janë vërejtur në Sanxhak gjatë 10 deri 15 viteve të fundit me praktikat vahabe dhe salafe. Ka patur disa incidente ku pjesëtarë të lëvizjes vahabe janë përpjekur të imponojnë një lloj të caktuar të lutjes në disa xhami, kanë ndërprerë koncerte me muzikë dhe kanë shpërndarë fletushka ku shpjegohet se cilat praktika janë pranueshme dhe të papranueshme në islam. Incidenti më i rëndë ka ndodhur në vitin 2007 kur një grup i praktikuesve vahabi u arrestuan dhe u akuzuan për organizmin e një kampi stërvitjeje pranë fshatit Zhabren ndërmjet Sijenicës dhe Novi Pazarit. Të dy grupet vahabi u dënuan për terrorizëm.

Ky incident ishte i paprecedentë në Novi Pazar dhe Sanxhak dhe vahabitë dhe salafët nuk u panë më nëpër rrugë. Mirëpo gjatë viteve të fundit në Novi Pazar ka patur një rritje të numrit të grave, sidomos të reja dhe të vajzave, që mbajnë veshje më tradicionale islame si hixhabi. Kjo vërehet të jetë dhe trendi i përgjithshëm në vendet e ish-Jugosllavisë, sidomos pas luftërave të viteve 90-të dhe pas shpërbërjes së ish-shtetit. Të rinj serbë, kroatë, boshnjakë dhe shqiptarë vazhdimisht po drejtohen nga kombi dhe feja e tyre. Në rastin e myslimanëve, përqendrimi tek apo ''kthimi" në islam ka ndërlikime të karakterit vendor dhe ndërkombëtar. Pas luftës në Bosnje dhe si kundërpërgjigje ndaj krimeve të shumta, ndërgjegjja dhe krenaria kombëtare dhe fetare e boshnjakëve është forcuar. Luftërat në vendet myslimane dhe shfaqja në rritje e ksenofobisë në Evropë kanë patur si rezultat që të rinj boshnjakë të kthehen drejt fesë dhe të largohen nga vlerat perëndimore.

Udhëheqësit islamikë, pavarësisht bashkësisë fetare prej nga vijnë, rregullisht i dënojnë krimet e luftës, dukuritë ekstremiste dhe aktet terroriste që individët me gjasë kryejnë në emër të islamit. Udhëheqësit theksojnë nevojën për respekt të ndërsjellë dhe bashkëekzistencë ndërmjet feve të ndryshme dhe avokojnë që myslimanët vendas të vazhdojnë të respektojnë islamin tradicional që praktikohet në këtë rajon prej shekujsh. Ish-myftiu Muamer Zukorlliq, i cili është akuzuar se ka mbështetur rritjen e vahabizmit ekstrem në Sanxhak dhe që thuhet se ka qenë në shënjestër të një sulmi të planifikuar terrorist si ''agjent i CIA-s" gjatë gjykimit të një grupi vahabish, u bë udhëheqësi i Bashkësisë Demokrate Bsohnjake në Sanxhak dhe

deputet në Kuvendin e Serbisë. Zukorlliqi, që më parë është akuzuar për ekstremizëm dhe separatizëm nga pjesa më e madhe e medias serbe u bë partneri politik i zyrtarëve nga Beogradi. Ai avokon për pajtimin ndërmjet serbëve dhe boshnjakëve, myslimanëve dhe të krishterëve, po pa harruar krimet.

''Çështje të tilla të rëndësishme nuk mund të lihen pas; nuk mund të ndalosh së numëruari viktimat. Krimet janë diçka që duhen dënuar, kryerësit duhen ndjekur penalisht dhe kjo është detyrë e gjyqësorit dhe e institucioneve të tjera, mirëpo duhet të ketë parime. Procesi mund të zhvillohet më tej vetën nëse ka parime. Ai nuk mund të zhvillohet duke mohuar, zvarritur apo fshehur ato që kanë ndodhur. Është shumë e rëndësishme që të mblidhemi dhe të themi se dëshirojmë dialog, se dëshirojmë ta tejkalojmë. Jo ta shtyjmë, harrojmë apo minimizojmë", tha Zukorlliq. Duke folur për çështjen e radikalizimit, Zukorlliqi thekson se ''zjarri nuk shuhet me zjarr" dhe se është e nevojshme që të krijohet një mjedis ku idetë ekstreme nuk janë tërheqëse dhe se përmirësimi i gjendjes ekonomike dhe shoqërore në Sanxhak është me rëndësi. ''Ne duam të shohim një Sanxhak të fortë për kulturë, ekonomi, transport, si një bërthamë të së ardhmes kolektive në Serbi, Mal të Zi, Bosnje e Hercegovinë dhe Kosovë. Sanxhaku është në kryqëzim, ndërmjet autostradës nga Beogradi drejt detit, nga Sarajeva drejt Novi Pazarit. As Serbia, as Mali i Zi nuk duhet të frikësohen nga një Sanxhak dhe boshnjakë të tillë. Ne e kemi dëshmuar se nuk plaçkisim dhe nuk sulmojmë. Me një investim të tillë, ne dëshirojmë një Serbi ku të gjithë janë të barabartë dhe respektojnë njëri-tjetrin. Sepse ai është shteti që duam të ndërtojmë dhe të krijojmë", ka thënë Zukorlliqi gjatë mitingjeve të tij zgjedhore.

Bashkësia Islame e Serbisë, e udhëhequr nga reis-ul-ulema-ja Sead Nasufoviq, rregullisht i dënon krimet ekstremiste dhe avokon për një jetë tolerante, shumëetnike dhe shumëfetare. Edhe pse zyrtarisht Nasufoviqi është udhëheqësi, kjo bashkësi fetare është e lidhur me familjen Jusufspahiq, që kanë kontrolluar bashkësinë myslimane në Beograd për shekuj të tërë. Shumë myslimanë, sidomos në Sanxhak, nuk janë të kënaqur me faktin që Jusufspahiqët janë të lidhur me politikanët të cilët kanë sjellë aq shumë konflikte për myslimanët në rajon – Sllobodan Millosheviqn dhe Vojislav Sheshelin. Jusufspahiqët dhe bashkësia islame kanë marrëdhënie të mira me autoritetet dhe i vënë në dukje lidhjet me Serbinë si dhe kundërshtimin që kanë ndaj ekstremizmit. ''Aty ku jemi dhe atje ku po shkojmë, nuk ka ekstremizëm", thotë Muhamed Jusufspahiq, ish-myftiu i bashkësisë islame të Serbisë në vitin 2007. ''Ne, myslimanët në Serbi, të gjithë ne për të cilët Allahu është më i rëndësishëm se çdo krijesë, e dënojmë dhunën, vrasjet dhe intrigat që çojnë në vrasje", ka thënë Jusufspahiqi atëherë ndërsa komentonte për sulmet terroriste në disa vende të Evropës.

***Safeta Bishevac** është gazetare e gazetës ditore "Danas" në Beograd si dhe bashkë-redaktore e gazetës ditore "Sandžak Today". Gjatë karrierës së saj të gjatë në gazetari, Safeta është marrë me politikën e brendshme, me çështjet humanitare në rajon dhe me të drejtat e njeriut. Në mesin e shumë temave, ajo ka raportuar për protestat studentore në vitet 1996-1997, për Asamblenë Parlamentare të Serbisë, për procedurën gjyqësore ndaj Sllobodan Millosheviqit në Hagë dhe është marrë me çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.*

Autor: Randall Puljek-Shank

BESIMTARËT PËR PAQE

"Besimtarët për Paqe" është një nismë ndërfetare që nisi në vitin 2006. Grupi tetë anëtarësh i besimtarëve që udhëheqin këtë nismë janë të krishterë dhe myslimanë nga Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia. Grupi ka qenë aktiv për ndërtimin e paqes për mjaft vite. Nisma "Besimtarët për Paqe" sillet rreth një vizioni të përbashkët ''Duke ndërtuar paqen, ne i thurrim lavde Zotit", që është dhe tematika e mbledhjeve paqësore dhe konferencave ndërfetare që organizon kjo nismë.

Deri më tani janë mbajtur tri konferenca ndërfetare: në Kroaci në vitin 2006 (Ishulli Krk), në Bosnje e Hercegovinë në vitin 2008 (në Blagaj pranë Mostarit) dhe në Serbi në vitin 2010 (në Andrevlje, Vojvodinë). Konferenca e radhës është planifikuar të mbahet në Kroaci në vitin 2017 (në Omish). Konferencat kanë qenë mundësi për besimtarët e interesuar në ndërtimin e paqes që të takohen dhe temat kishin të bënin me mundësinë që kanë fetë abrahamike të ndërtojnë paqen duke lidhur përmbajtjen fetare dhe jo-dhunën si një qëndrim dhe mënyrë sjelljeje të aktivizmit shoqëror. Qëllimi i takimeve gjatë konferencave ka qenë zbulimi dhe mësimi i ndikimit të paqes, të koncepteve dhe teologjive me qëllim të ndërgjegjësimit të besimtarëve për përgjegjësinë e tyre në ndërtimin e shoqërisë civile.

Deri më tani me punën e vet, Nisma "Besimtarët për Paqe" ka inkurajuar besimtarët që të mësojnë dhe të thellohen në tekste fetare që të fuqizohen për të punuar për ndërtimin e paqes dhe t'i kontribuojnë një bashkëekzistence paqësore në shoqëritë të cilave u përkasin duke praktikuar fenë e tyre në mënyrë aktive.

Në vitin 2013, grupi "Besimtarët për Paqe" filloi një nismë të quajtur "Deklarata e Besimtarëve për Paqe". Deklarata përmban parimet në bazë të të cilave një besimtar që punon në mënyrë aktive për paqen të marrë mirënjohje. Këto kritere janë edhe udhëzues për veprimtari jo të dhunshme. Deklaratën mund ta nënshkruajë çdo person dhe kështu e detyron veten në mënyrë simbolike që të bëjë përpjekje për të ndërtuar paqen përmes veprimeve jo të dhunshme dhe duke marrë forcë dhe motivim nga feja e tyre.

Në tetor të vitit 2013, deklarata u paraqit në Berko pranë Vukovarit dhe në Vinkovci, si pjesë e lutjes së Shën Françeskut. Në dhjetor të të njëjtit vit, deklarata u promovua në praninë e më shumë se njëqind pjesëmarrësve në Qendrën e Bashkësisë Islame në Rijeka.

Në fillim të qershorit 2014, deklarata u prezantua në Sarajevë si pjesë e përkujtimit paqësor me rastin e 100 vjetorit të fillimit të Luftës së Parë Botërore (''Ngjarja e Paqes në Sarajevë 2014").

Më 1 janar 2015, "Besimtarët për Paqe" publikuan një apel për paqen një javë para sulmit tragjik kundër Çarli Hebdos në Paris. Ai apel adresonte çështjen e mostolerancës së heshtur në Evropë dhe në shoqërinë tonë të shfaqur në formën e islamofobisë. U nxor një paralajmërim se forma të ndryshme të fobisë rrezikojnë jo vetëm pjesëtarët e një grupi të caktuar fetar, por edhe paqen si një e mirë e të gjithë qytetarëve. Përveç natyrës së vet të përgjithshme, apeli kishte dhe një aspekt praktik, pasi propozonte hapa specifikë që mund të ndërmarrë çdo person kur lufton mungesën e tolerancës dhe paragjykimet.

Grupi organizativ i kësaj nisme takohet dy deri në tre herë në vit gjatë fundjavave konsultative. Këto konsultime janë raste për identifikimin e çështjeve të ditës për ndërtimin e paqes ndërfetare që duhet të trajtohen gjatë periudhës në vijim. Tema e konferencës së radhës do të përqendrohet në çështjen se si "Besimtarët për Paqe" duhet t'i trajtojnë problemet në kohë nacionalizmi dhe ksenofobie.

Të gjithë këto aktivitete kanë patur rezultatin e dëshiruar, përkatësisht rritjen e numrit të qytetarëve të krishterë dhe myslimanë nga Evropa Juglindore që identifikohen me emërtimin "besimtar për paqe" dhe e dërgojnë mesazhin e nismës "Besimtarët për Paqe" si mesazhin e tyre.

Nisma Besimtarët për Paqe ndërlidhet me nisma të ngjashme, rrjete dhe organizata si rrjeti evropian Kisha dhe Paqja, lutja e Shën Françeskut dhe grupi me të njëjtin emër, Croyants pour la paix nga Franca dhe Gläubige für den Frieden.

FEJA DHE POLITIKA

Duke patur parasysh kushtet e ndryshme socio-historike në pjesë të ndryshme të botës, janë zhvilluar koncepte të ndryshme për shtetin dhe femë dhe marrëdhënien ndërmjet tyre. Shpeshherë, politika dhe feja janë të ndërlidhura. Fetë kanë themeluar vende, por edhe shtetet kanë mbështetur dhe fuqizuar fetë. Po ashtu, me anë të revolucioneve dhe ndikimin gradual, fetë kanë ndryshuar struktura sociale, aparatin e vendit apo të shtetit dhe nëse nuk kanë sjellë ndryshime, këto shpesh janë përshtatur dhe janë marrë nën kontroll të feve.

Ndërsa në kohërat e hershme feja dhe shteti ishin të lidhur shumë ngushtë, studimet empirike tregojnë se në dy dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit të kaluar dhe në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit 21, shekullarizmi është rritur dhe roli i fesë në shoqëri është pakësuar. Shekullarizëm nënkupton që feja dhe besimi janë pjesë e sferës private të secilit individ dhe nuk angazhohen në politikëbërje apo udhëheqje të shtetit. Në dhjetëvjeçarin e dytë të këtij shekulli, sidomos në Evropën Juglindore dhe Qendrore, ekziston një trend në rritje i rifuqizimit të marrëdhënies ndërmjet fesë dhe politikës dhe Shtetit.

Republika e Maqedonisë është vend shekullar sipas Kushtetutës dhe ligjeve që ndajnë politikën formale nga feja dhe garantojnë respektim të plotë dhe mbrojtje të pluralizmit fetar. Meqë në vendin tonë ka shumë pak studime empirike lidhur me çështjen e fesë dhe politikës, na duhet të mbështetemi kryesisht tek përvojat tona, media dhe perceptimet e përditshme të zyrtarëve tanë të zgjedhur.

Duke parë dalldinë në media gjatë festave kryesore fetare kur udhëheqës partiakë shtetërorë shihen në Kishë ose Xhami, mua sistemi nuk më duket shumë shekullar. Personalisht, si një besimtar, nuk më intereson se cili nga udhëheqësit tanë gjen monedhën kur pret të ashtuquajturën bukë e Krishtlindjeve apo cilat festa fetare ata festojnë.

Feja nuk duhet të merret vetëm si traditë folklorike që siguron më shumë vota. Gjithashtu ajo nuk duhet të ndikojë tek vendimmarrja politike apo zhvillimi i politikave. Për fat të keq, politika në Maqedoni arsyetohet përmes argumentave fetarë. Për shembull, politika e qeverisë për familje të mëdha mbështetet tek besimi i krishterë dhe mysliman se aborti është një nga mëkatet/gjynahet më të mëdha. Ligji që ndalon abortin i pengon gratë nga e drejta për të vendosur të pavarura a të kenë apo jo një fëmijë. Një tjetër shembull është të kuptuarit e orientimit seksual që për elitat tona politike është identik me të kuptuarit që kanë dy bashkësitë më të mëdha fetare, Kisha Ortodokse Maqedonase – Patrikana e Ohrit dhe bashkësia myslimane. Islami dhe krishtërimi pretendojnë se marrëdhëniet homoseksuale janë në kundërshtim me mësimet e Zotit ashtu si përshkruhen në Bibël dhe në Kuran.

– NJË KOKTEJ I RREZIKSHËM

Në kontekstin e Maqedonisë, jo vetëm politika dhe feja janë të ndërlidhura në mënyrë të rrezikshme. Këtij kokteji të rrezikshëm i shtohen edhe identitetet etnike të qytetarëve dhe ato keqpërdoren nga lëvizjet nacionaliste. Sot, që të jesh një "maqedonas i vërtetë" dhe patriot nënkupton të jesh i krishterë ortodoks dhe nga ana tjetër, "shqiptar i vërtetë" kryesisht nënkupton të jesh mysliman dhe suni.

Përzierja e politikës, fesë dhe identiteteve etnike nxit konflikte dhe tensione në vendin tonë dhe nuk na e bëjnë të mundur të merremi me të kaluarën në mënyrë konstruktive. Trendi në rritje i afrimit të fesë dhe politikës përgjatë dhjetë viteve të fundit në Maqedoni në afat të gjatë po dëmton qytetarët e Maqedonisë në rast se nuk do të jemi në gjendje të tejkalojmë përçarjet që shumë shpesh promovohen nga udhëheqësit tanë.

Todor Pendarov *është gazetar, analist politik dhe pjesëtar i Parlamentit të Republikës së Maqedonisë.*

***Muhamed Jusiq** është teolog islam, ekspert i studimeve arabe dhe analist i Lindjes së Mesme dhe Ballkanit. Ai është dhe autor i disa librave dhe studimeve për botën arabe dhe islamin. Muhamedi është kontribues për Al Jazeera Balkans, StartBiH, Oslobođaenje dhe Preporod. Ai bashkëpunon edhe me Qendrën për Studime të Avancuara në Sarajevë dhe është Koordinator i Projektit për Islamin në Evropën Juglindore.*

Sfidat me ballafaqimin me të kaluarën; besimtarët dhe bashkësitë fetare

Në mesin e popujve që kanë jetuar të integruar në këtë rajon për shekuj të tërë, procesi i ballafaqimit me të kaluarën, shërimi i përvojave traumatike nga luftërat dhe procesi i pajtimit janë tani sfidat kryesore në jetën e tyre shoqërore, ekonomike dhe fetare. Nga përvoja jonë dhe nga përvoja e shumë akterëve të tjerë që janë pjesë e dialogut ndërfetar, është bërë e qartë se në rastin e Bosnje e Hercegovinës nuk mund ta shmangim mungesën e gatishmërisë për t'u përballur me gjendjen e krijuar gjatë luftës dhe që arriti kulmin me tmerret që u kryen. Ndryshe nga sa mendojnë njerëzit, kjo mungesë e gatishmërisë gjendet edhe në mesin e personave që përfaqësojnë bashkësi fetare apo që pretendojnë të jenë besimtarë. Çështja e ballafaqimit me të kaluarën është një minë që pret të shpërthejë dhe nga e cila kanë frikë organizatorët e takimeve ndërfetare.

Kjo është e ngjashme me rastin e normalizimit të çdo marrëdhënieje tjetër, që nga kthimi i të zhvendosurve deri tek bashkëpunimi më intensiv ekonomik dhe kulturor në rajon. Prandaj, është e domosdoshme që ne si shoqëri të fillojmë të merremi me të kaluarën dhe të ndalojmë prodhimin e të vërtetave dhe narrativave paralele.

Bashkësitë fetare kanë aftësinë dhe duhet të angazhohen në këto bisedime për të siguruar një proces më të mirë të shërimit. Edhe pse ata nuk mund të vërtetojnë faktet e vuajtjes dhe aq shkaqet e konfliktit, ata mund të krijojnë një mjedis ku këto çështje të diskutohen pa paragjykim, shqetësim apo manipulim me emocione. Bashkësitë fetare dhe besimtarët mund t'i kontribuojnë dukshëm zhvillimit të ballafaqimit me të kaluarën të shoqërisë sonë dhe rindërtimit të besimit duke promovuar idenë e dialogut ndërfetar.

Bashkësitë fetare dhe pajtimi

Deri tani, përpjekjet për t'i kontribuar procesit të ballafaqimit me të kaluarën të bashkësive fetare në Bosnje janë kufizuar tek dialogje ndërfetare të cilave u mungonte një lidhje e qartë me përditshmërinë e njerëzve në Bosnje. Kështu, suksesi i tyre ka qenë shumë i kufizuar.

Arsyet se përse bashkësitë fetare si dhe media ngurrojnë të fillojnë procesin e ballafaqimit me të kaluarën interpretohen nga shoqëria civile se këta sektorë të bashkësisë nuk janë të gatshëm të rishikojnë rolet që kanë luajtur gjatë luftërave në rajon.

Kur pyeten për mungesën e udhëheqësisë nga bashkësitë fetare gjatë procesit të pajtimit në Bosnje, përfaqësues të bashkësive fetare kryesisht përgjigjen se nuk mund të pritet nga ata që ta fillojnë një proces të tillë, pasi ai ka të bëjë me të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe përmban sfida të shumta. Mirëpo kjo është pikërisht arsyeja se përse bashkësitë fetare duhet të marrin pjesë në procesin e ballafaqimit me të kaluarën dhe secila prej tyre duhet ta përcaktojë këtë si qëllimin e vet kryesor.

Dialogu ndëfetar dhe procesi i ballafaqimit me të kaluarën

Pavarësisht sfidës së ballafaqimit me të kaluarën që shihet si një pengesë për dialogun ndërfetar, është fakt se bashkësitë fetare në Bosnje e Hercegovinë kanë bërë hapat e parë formalë drejt dialogut ndërfetar që mund t'i paraprijë pajtimit. Numri i nismave për dialog dhe bashkëpunim ndërfetar në bashkësitë lokale është rritur. Mirëpo gjatë këtyre mbledhjeve, çështja e trashëgimisë së luftës kryesisht anashkalohet dhe secilën herë bëhet më e qartë se ende nuk ka pajtim për një të kuptuar të përbashkët apo vizion të përbashkët se si të vazhdohet më tutje. Shembuj të shumtë nga bashkësitë lokale tregojnë se nismat për dialog nga bashkësitë fetare në disa raste çojnë drejt mospajtimeve dhe konflikteve. Për të filluar diskutimin rreth çështjeve komplekse të shoqërisë sonë në Bosnje e Hercegovinë, ne duhet të shqyrtojmë rolet e mundshme që kanë bashkësitë fetare.

Mundësitë për ballafaqimin me të kaluarën

Në përpjekje për t'u ballafaquar me të kaluarën, Bosnja dhe Hercegovina duhet të shqyrtojnë dhe të mësojnë nga përvoja e konflikteve të tjera dhe të sigurojnë zgjidhje efektive, por duke shmangur gabimet dhe negativitetet gjatë proceseve të tilla. Edhe pse nuk ka zgjidhje të gatshme kur kemi parasysh kontekstin lokal kulturor, historik dhe politik të rajonit, sërish ne duhet të shqyrtojmë përvojat, si rasti i Gjermanisë, Finlandës, Afrikës së Jugut dhe të tjerë. Do të ishte humbje kohe të presim për elitat politike, fetare dhe akademike të shoqërisë sonë që të pajtohen për procesin e ballafaqimit me të kaluarën në Bosnje e Hercegovinë. Prandaj, nismat nga niveli bazë, pavarësisht se sa të vogla janë, nuk duhen shpërfillur.

Për më tepër, bashkësitë lokale kanë potencial të konsiderueshëm në mësimet e tyre bazë që mund t'i ndihmojnë procesit të ballafaqimit me të kaluarën, ndërtimit të paqes dhe pajtimit. Kryesisht e kam fjalën për institucionin e faljes dhe hapjen e derës për pendim, që na mësojnë të gjitha fetë.

Ndjenjat fetare mund t'i mobilizojnë individët më shpejt se çdo formë tjetër e identitetit. Kjo është arsyeja përse ato përdoren më shpesh për t'i mobilizuar njerëzit për luftë dhe për të arsyetuar dhunën. Mirëpo pikërisht ky fakt, fuqia e tij pabesueshmërisht e shpejtë dhe efektive, mund të japë kontribut të vlefshëm për të promovuar mospërdorimin e dhunës, pajtimin dhe ndërtimin e paqes në bashkësi dhe shoqëri të paskonfliktit.

Sigurisht është interesante të vëmë në dukje se ky rajon ka një nga nivelet më të larta të fetarisë publike, mirëpo nga përvojat e mia personale, niveli i përgjegjësisë morale për veprimet individuale apo kolektive është shumë i ulët. Kjo gjë shndërrohet në detyrim të dukshëm, mirëpo edhe në një mundësi që bashkësitë fetare të kontribuojnë që kjo fetari të kanalizohet ndryshe, sepse nuk ka shumë gjasa që procesi i pajtimit të bëhet pa gatishmërinë

që të merret përsipër përgjegjësia kolektive dhe morale. Duke patur parasysh kundërshtitë rreth çështjes së përgjegjësisë kolektive, edhe nëse dikush nuk është direkt përgjegjës për atë që pjesëtarët e bashkësisë së vet kanë bërë në emër të saj, ata janë përgjegjës se çfarë raporti kanë ndërtuar me këtë çështje tani.

Një tjetër aspekt që duhet të marrim parasysh kur shqyrtojmë proceset e ballafaqimit me të kaluarën është turpi, që luan një rol me rëndësi në shoqërinë tonë. Shpeshherë, përpjekjet për falje dhe pajtim braktisen pasi ka shumë pasiguri se si viktimat duhet dhe mund të përfshihen në proceset e ballafaqimit me të kaluarën. Megjithatë, kjo nuk mund të jetë zgjidhja e vërtetë: të falësh dhe të harrosh nuk janë e njëjta gjë, sepse për të harruar, duhet të kemi kujtesë aktive të asaj që ka ndodhur; për të falur, ne duhet të dimë saktë se çfarë po falim.

Luftërat e tmerrshme që u zhvilluan në Bosnje e Hercegovinë dhe në vende të tjera të rajonit gjatë viteve ’90 kanë çuar në përçarje të paprecedentë të shoqërisë përgjatë vijave etnike. Për rajonin e përgjakur të Ballkanit me një gjendje të tillë aktuale të mostolerancës, historia tregon se që nga periudha osmane dhe periudha të tjera të mëvonshme, kjo gjendje është e panatyrshme. Bashkësitë në këtë rajon kanë histori të gjatë dhe të pasur të bashkë-ekzistencës, shumëkulturalizmit, shumë besimeve fetare dhe vlerave tradicionale që kanë mbizotëruar pavarësisht periudhave të tmerrshme nëpër të cilat ka kaluar kjo pjesë e Evropës. Kjo na jep shpresën se nëse krijohen kushtet e duhura, popujt në këtë rajon do ta rifitojnë këtë shpirt dhe do të gjejnë një mënyrë për të jetuar bashkë dhe të krijojnë një të ardhme më të mirë për të gjithë popujt në Evropë dhe më gjerë.

lajme dhe përditësime

Me 1 qershor lansohet seksioni i ri BLOG/VLOG në uebfaqen Ballafaqimi me të Kaluarën

Blogu Ballafaqimi me të Kaluarën, produkti i ri medial i platformës online për Ballafaqimin me të Kaluarën www.dwp-balkan.org, u lansua zyrtarisht me 1 qershor 2017. Blogu BmK është platformë rajonale online për reflektime konstruktive lidhur me tema që kanë të bëjnë me të kaluarën me qëllim të fuqizimit të qasjes së hapur dhe konstruktive në nivel rajonal. Ky mjet i Blog/Vlog do të përdoret për të promovuar diskutime online konstruktive që kanë të bëjnë me temat aktuale në fushën e ballafaqimit me të kaluarën.

I ftojmë të gjithë blogerët/vlogerët nga Ballkani Perëndimor e interesuar për temat e ballafaqimit me të kaluarën dhe të gatshëm të hapin debate konstruktive mbi këto tema që të bëheni pjesë e kësaj platforme të re mediale dhe të na kontaktoni nëse doni të kontribuoni për Blogun/Vlogun apo nëse keni nevojë për informacion shtesë.

Ju lutemi të kontaktoni me Sunita Dautbegoviq-Boshnjakoviq, Menaxhere e Projektit, forumZFD në Sarajevë në adresën e postës elektronike bosnjakovic@forumzfd.de ose info@dwp-balkan.org.

numri i radhës

Numri i tetë i revistës Balkan.Perspectives do të merret me çështjen se përse duhet ta kemi parasysh ballafaqimin me të kaluarën kur flasim për arsimin. Ne po shqyrtojmë se si nacionalizmi po përhapet përmes shkollave dhe universiteteve, mirëpo dëshirojmë edhe të paraqesim shembujt më të mirë nga praktika se si institucionet e arsimit formal dhe joformal promovojnë mënyra gjithëpërfshirëse të kujtesës.

Impressum

Balkan.Perspectives botohet nga *forum*ZFD.

Forumi i Shërbimit Civil Paqësor (forumZFD - Forum Ziviler Friedensdienst), është organizatë gjermane e themeluar në vitin 1996. Kjo organizatë trajnon dhe angazhon ekspertë të paqes në rajonet e konfliktit që të bashkëpunojnë me akterët vendorë për të promovuar bashkëjetesë paqësore dhe zgjidhje pa dhunë të konflikteve. Partneri strategjik për Ballkanin Perëndimor është Pax Christi në Dioqezën e Aachen.

Në Ballkanin Perëndimor, fokusi është tek projekte në fushën e ballafaqimit me të kaluarën dhe për zhvillim të dialogut në mes të grupeve kundërshtare. Këtu përfshihen projektet e ndërmjetësimit nëpër shkolla, mbështetja e shoqërisë civile ose zhvillimi i kapacitetit të medias për një qasje më konstruktive ndaj ballafaqimit me të kaluarën.

Programi financohet nga Ministria Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik e Gjermanisë (BMZ).

KRYEREDAKTORE:
Maike Dafeld

EKIPI REDAKTUES:
Sunita Dautbegoviq-Boshnjakoviq, Vjollca Islami Hajrullahu, Nora Maliqi, Vjera Ruljic, Nehari Sharri

AUTORË:
Safeta Bishevac, Dardan Hoti, Muhamed Jusiq, Shpëtim Nuredini, Todor Pendarov, Zlatiborka Popov Momçinoviq

DIZAJNI:
Kokrra

PRINT:
Envinion

PËRKTHIMI:
LBG Communications (shqip), Bjanka Osmanoviq (BKS), Reis Kjerim (maqedonisht)

KORREKTURA GJUHËSORE:
LBG Communications (shqip), Violeta Kostadinoska (maqedonisht), Zinaida Llakiq (BKS), Tenzin Dolker (anglisht)

KONTAKT:
*Balkan.perspectives@forum*zfd.*de*

VENDI I BOTIMIT
Cologne

Forumi i Shërbimit Civil Paqësor |Forum Ziviler Friedensdienst e. V. (forumZFD)

Zyra në Kosovë: Sejdi Kryeziu 16 - Pejton 10000 Prishtinë	Zyra në Serbi: Prote Mateje 17 11000 Belgrade
Zyra në Bosnie e Hercegovinë: ul. Branilaca Sarajeva 19 B 71000 Sarajevo	Zyra në Maqedoni: ul. Borka Taleski 11/4 1000 Skopje

Mohim i përgjegjësisë

Balkan.Perspectives është krijuar si një platformë rajonale për debate konstruktive mbi ballafaqimin me të kaluarën. Pikëpamjet e shprehura në këtë revistë janë ato të kontribuesve përkatës dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e redaktorit apo të forumZFD-së dhe partnerëve të tij. Botuesit i kanë kontrolluar me kujdes lidhjet e internetit të promovuara në këtë revistë, por ata nuk mund të mbahen përgjegjës për përmbajtjen e faqeve të jashtme të internetit.

Kopjimi dhe rishpërndarja e këtij materiali, qoftë në formë të shtypur apo elektronike është i pranueshëm, por vetëm nëse teksti nuk ndryshohet dhe nëse përfshihen citimet e duhura. Për këtë nuk kërkohet pagesë.